



Shoqata për Persona me Aftësi të Kufizuara
Rr: "Ali Ajeti"-Podujevë, Nr:38
Tel: +37744319807

Komuna e Podujevës
Opština Podujevo
Municipality of Podujeva

Duke u bazuar në nenet 11,58 të Ligjit Nr.03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, neneve 14,61 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas Marrëveshjen e Mirëkuptimit të lidhur mes NLB Banka Sh.A me seli në Prishtinë dhe Komunës së Podujevës datë 13.12.2023, lidhet:

MARREVESHJE E MIRËKUPTIMIT

Në mes:

KOMUNËS SË PODUJEVËS- e përfaqësuar nga z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës

dhe

SHOQATËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS PODUJEVA"
me seli në Podujevë, të cilën e përfaqëson drejtori i shoqatës z.Idriz Hoxha.

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes:

Objekt i kësaj Marrëveshje të Mirëkuptimit është dhënia në shfrytëzim pa kompensim të automjetit të Komunës së Podujevës për nevoja të Shoqatës "Handikos Podujeva".

Neni 2

Qëllimi;

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është implementimi i Marrëveshjes për Donacion Bamirësie datë 13.12.2023 e lidhur në mes NLB Bank Sh.A me seli në Prishtinë rr." Ukshin Hoti" dhe Komunës së Podujevës, sipas të cilës automjeti Kombi Volkswagen VW 7HC me numër të shasisë WV2ZZZ7HEHO87057 i është dhënë donacion Komunës së Podujevës, me destinim që i njëjti ti jepet në shfrytëzim ekskluzivisht vetëm Shoqatës për personat me aftësi të kufizuara "Handikos Podujevë", për plotësimin e nevojave të tyre.

Neni 3

Komuna e Podujevës, automjetin e lartcekur, e jep në shfrytëzim në gjendje të rregullt, që nënkupton pa të meta juridike dhe funksional për kryerjen e nevojave të Shoqatës "Handikos"-Podujevë

Neni 4

Shfrytëzimit i automjetit të cekur sipas kësaj marrëveshje të mirëkuptimit jepet në kohë të pacaktuar, përkatësisht deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 5

Shoqata "Handikos Podujeva", merr për obligim heqjen e të gjitha shpenzimeve rreth shfrytëzimit të automjetit, shpenzimet e riparimeve të rëndomta dhe heqjen e shpenzimeve të dëmit eventual që mund të shkaktohet dhe që janë jashtë rasteve të siguruara nga kompania e sigurimeve në Kosovë, si dhe shpenzimet e regjistrimit të automjetit.

Neni 6

Shoqata "Handikos Podujeva", obligohet që automjetin e lartëcekur ta shfrytëzoj sipas destinimit siç është përcaktuar në këtë marrëveshje të mirëkuptimit, duke respektuar rregullat dhe parimin e mirëbesimit.

Neni 7

7.1 E drejta e shkëputjes të njëanshme të kësaj marrëveshje të mirëkuptimit, aktivizohet në rastet e shkeljeve të rënda të obligimeve dhe në veçanti me rastin e shkeljes së detyrimeve që janë të përcaktuara me këtë marrëveshje të mirëkuptimit, duke e njoftuar njëra palë tjetrën 5 ditë përpara shkëputjes së marrëveshjes.

7.2 Me rastin e shuarjes apo falimentimit të Shoqatës "Handikos Podujeva", automjeti i lartëcekur i kthehet Komunës së Podujevës.

Neni 8

Të gjitha palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj marrëveshje të mirëkuptimit dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësive në tekstin e kësaj marrëveshje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim, në të kundërtën do të vendoset në Gjykatën kompetente.

Neni 9

Kjo marrëveshje e mirëkuptimit është hartuar në 4 ekzemplar identik ku nga një e marrin palët, kurse të tjerat mbesin për nevojat e organit kompetent.

Palët nënshkruese:

Kryetari i Komunës

Shpejtim Bulliqi



Podujevë, 28.05.2024

Drejtori "Handikos Podujevë"

Idriz Hoxha

